



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë-Ministarstvo Pravde-Ministry of Justice
Shërbimi Korrektues i Kosovës/Korrektivna Sluzba Kosova/Kosovo Correctional Service
Drejtoria e Përgjithshme

Prishtinë: 28.03.2025

Duke u bazuar në nenin 12, paragrafi 1, nën paragrafi 1.10 të ligjit nr.08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës, Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës nxjerr:

V E N D I M

I. Miratohet Rregulla e Brendshme për Menaxhimin e të Burgosurve me Rrezikshmëri të Lartë dhe Shumë të Lartë.

II. Rregulla e Brendshme për Menaxhimin e të Burgosurve me Rrezikshmëri të Lartë dhe Shumë të Lartë do të zbatohet nga të gjitha Institucionet Korrektuese.

III. Vendimi hyn në fuqi nga data 10 Prill 2025.

Ismail Dibrani

Drejtor i Përgjithshëm
Shërbimi Korrektues i Kosovës

Vendimi ju dërgohet:

1. Institucioneve Korrektuese;
2. Arkivit të SHKK-së.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Drejtësisë-Ministarstvo Pravde-Ministry of Justice
Shërbimi Korrektues i Kosovës/Korektivna Služba Kosova/Kosovo Correctional Service
Drejtoria e Përgjithshme

RREGULL E BRENDSHME PËR
MENAXHIMIN E TË BURGOSURVE ME RREZIKSHMËRI TË LARTË
DHE SHUMË TË LARTË

Prishtinë, Mars 2025

Neni 1

Qëllimi

Të sigurohet menaxhimi efektiv i të burgosurve me rrezikshmëri të lartë dhe shumë të lartë duke parandaluar rreziqet për sigurinë e përgjithshme, stafin e institucionit dhe të burgosurit tjerë

Neni 2

Vendosja e të burgosurve të klasifikuar me rrezikshmëri të lartë dhe shumë të lartë

1. Të burgosurit e klasifikuar me rrezikshmëri të lartë dhe shumë të lartë:

1.1. vendosen në institucion të tipit të mbyllur, përjashtimisht të miturit dhe femrat vendosen në njësinë e tipit të mbyllur brenda institucionit;

1.2. i burgosuri i klasifikuar me rrezikshmëri të lartë dhe shumë të lartë duhet të vendoset në pavijon/krah ku mund të ofrohet niveli më i lartë i sigurisë;

1.3. i burgosuri i cili është i klasifikuar me rrezikshmëri të lartë dhe shumë të lartë i cili ka konflikt me të burgosurit tjerë nuk duhet të vendoset në të njëjtin krah të pavijonit;

1.4. nëse ekzistojnë kushtet i burgosuri duhet të lihet vetëm në dhomë

Neni 3

Vendosja e të burgosurve të klasifikuar me rrezikshmëri të jashtme të lartë dhe shumë të lartë

1. Të burgosurit e klasifikuar me rrezikshmëri të jashtme të lartë dhe shumë të lartë:

1.1. vendosen në pavijon/krah sipas planifikimit të dënimit dhe rregullës së brendshme të tretmanit për të burgosur;

1.2. mund të vendosen në dhomë me të burgosurit tjerë jo kategorizuar;

1.3. gjatë lëvizjeve jashtë institucionit libri i kategorisë duhet të jetë së bashku me pakon e arratisjes.

Neni 4

Veshja e të burgosurve të klasifikuar me rrezikshmëri të lartë dhe shumë të lartë

1. Të burgosurit e klasifikuar me rrezikshmëri të lartë pajisen me veshje ngjyrë të portokalltë me një shenjë dalluese në formë rrethi me ngjyrë të gjelbër e vendosur në pjesën e pasme të jelekut.

2. Të burgosurit e klasifikuar me rrezikshmëri shumë të lartë pajisen me veshje ngjyrë të portokalltë me një shenjë dalluese në formë rrethi me ngjyrë të zezë e vendosur në pjesën e pasme të jelekut.

3. Të burgosurit e klasifikuar me rrezikshmërisë të lartë dhe shumë të lartë gjatë lëvizjeve brenda institucionit duhet të kenë të veshur jelekun përkatës të rrezikshmërisë.

4. Për lëvizjet e të burgosurve me rrezikshmëri të lartë dhe shumë të lartë jashtë institucionit nuk kërkohet të mbajnë të veshur jelekun i cili identifikon nivelin e rrezikshmërisë.

Neni 5

Libri i kategorisë

1. Institucioni Korrektues siguron librin e kategorisë për secilin të burgosur të klasifikuar me rrezikshmëri të lart dhe shumë të lart në të cilin libër duhet të evidentohen:

1.1. të gjitha lëvizjet e jashtme dhe të brendshme;

1.2. libri i kategorisë plotësohet dhe mirëmbahet nga zyrtari korrektues.

2. Institucioni Korrektues siguron librin e kategorisë për secilin të burgosur të klasifikuar me rrezikshmëri të jashtme të lart dhe të jashtme shumë të lart në të cilin libër duhet të evidentohen:

2.1. të gjitha lëvizjet jashtë institucionit;

2.2. libri i kategorisë mbahen në dhomën e kontrollit të institucionit së bashku me pakon e arratisjes dhe në çdo rast të daljes së të burgosurit jashtë institucionit libri i dorëzohet zyrtarit përgjegjës të Njësisë për Përcjelljen e të Burgosurve i cili duhet të evidentoj lëvizjet, ndërsa në rastet kur i burgosuri vendoset në spital libri i dorëzohet zyrtarit përgjegjës për ruajtjen e tij.

3. Zyrtari përgjegjës i dhomës së kontrollit është i obliguar të evidentoj në librin e kategorisë çdo incident brenda institucionit në të cilin përfshihet i burgosuri i klasifikuar me rrezikshmëri.

4. Libri i kategorisë duhet të kontrollohet në baza ditore nga mbikëqyrësi i lartë ndërsa udhëheqësi në detyrë e kontrollon në mënyrë sistematike;

5. Libri i kategorisë duhet të ketë fotografinë e të burgosurit dhe të jetë pjesë dosjes së të burgosurit në rast të transferimit në institucionin tjetër. Nëse pamja e të burgosurit ndryshon, fotografia duhet të përditësohet.

6. Në rastet kur i burgosuri hiqet nga kategorizimi libri i kategorisë ruhet në arkivin e institucionit.

7. Libri i kategorisë për të burgosurit e klasifikuar me rrezikshmëri shumë të lartë duhet të jetë me ngjyrë të kuqe. Ndërsa libri i kategorisë për të burgosurit e klasifikuar me rrezikshmëri të lartë duhet të jetë me ngjyrë të kaltër.

Neni 6

Rutina ditore e të burgosurve të klasifikuar me rrezikshmëri të lartë dhe shumë të lartë

Drejtori i institucionit përcakton aktivitetet ditore me rutinë të veçantë për të burgosurit e klasifikuar me rrezikshmëri të lartë dhe shumë të lartë brenda institucionit.

Neni 7

Menaxhimi i të burgosurve me rrezikshmëri të lartë dhe shumë të lartë brenda institucionit

1. Në çdo rast kur kryesuesi i komisionit apo komisioni përkatës për vlerësimin e rrezikshmërisë të burgosurve përcakton rrezikshmërinë e lartë dhe shumë të lartë brenda institucionit, institucionet korrektuese obligohen të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme me qëllim të menaxhimit efektiv për të burgosurit sipas nivelit të tyre të rrezikshmërisë.

2. Drejtori i Institucionit Korrektues sigurohet se:

- 2.1. të burgosurit e klasifikuar me rrezikshmëri të lartë dhe shumë të lartë pajisen me jelekë sipas specifikave të përcaktuara në nenin 4 të këtij udhëzuesi;
- 2.2. janë regjistruar të gjitha lëvizjet e të burgosurve në librin e kategorisë;
- 2.3. aktivitetet janë duke u realizuar sipas rutinës;
- 2.4. se ndaj të burgosurve të klasifikuar me rrezikshmëri aplikohet sistemi i tretmanëve deri në tretmanin standard.

3. Zyrtarët Korrektues të caktuar në detyrë për mbikëqyrjen të burgosurve të klasifikuar me rrezikshmëri janë të obliguar të:

- 3.1. të përcjellin çdo lëvizje të burgosurve gjatë aktiviteteve brenda krahut dhe perimetrit të pavijonit;
- 3.2. mbajnë të informuar dhomën e kontrollit për çdo lëvizje jashtë krahut të pavijonit;
- 3.3. njoftojnë mbikëqyrësin apo mbikëqyrësin e lartë kujdestar për çdo incident apo mosmarrëveshje me të burgosurit e kësaj kategorie.

Neni 8

Kontrollimet e të burgosurve (bastisjet)

1. Të burgosurit e klasifikuar me rrezikshmëri të lartë dhe shumë të lartë duhet të kontrollohen me detektorë dore apo statik si dhe me prekje për të burgosurit të cilët hyjnë dhe dalin nga institucioni apo nga pavijoni, ndërsa për lëvizjet brenda krahut të pavijonit kontrollimet (bastisjet) bëhen përmes detektorit dhe nëse ka dyshime për gjësende të palejuara mund të bëhen edhe kontrollime (bastisje) me prekje nëse nuk është përcaktuar ndryshe me dispozitat ligjore në fuqi.
2. Dhomat ku janë të vendosur të burgosurit e klasifikuar me rrezikshmëri të lartë dhe shumë të lartë duhet të kontrollohen së paku një (1) herë në javë. Varësisht nga situata apo duke u bazuar në informacione që mund të rrezikohet siguria e të burgosurve apo ajo e institucionit mund të realizohen kontrole me të shpeshta.
3. Së paku dy zyrtarë korrektues duhet të jenë në proporcion me një të burgosur gjatë kontrollimit të dhomës. Të gjitha kontrollimet e dhomave duhet të evidentohen në librin e kategorisë dhe formularin përkatës.

Neni 9

Lëvizjet e të burgosurve të klasifikuar me rrezikshmëri brenda dhe jashtë pavijonit

1. Zyrtari Korrektues i caktuar në detyrë në krahun ku janë të vendosur burgosurit e klasifikuar me rrezikshmëri të lartë dhe shumë të lartë para çdo lëvizje duhet të koordinohet me Dhomën e Kontrollit dhe pas pranimit të konfirmimit lejon lëvizjen e të burgosurve.
2. Në rastet kur të burgosurit duhet të dalin jashtë perimetrit të pavijonit të njëjtit duhet të përcjellën nga zyrtarët korrektues të divizionit të sigurisë.

3. Të gjitha lëvizjet jashtë pavijoni duhet të bëhen një nga një në mënyrë të organizuar.
4. Të gjitha lëvizjet e të burgosurve të klasifikuar me rrezikshmëri jashtë institucionit të autorizuar nga Drejtori i Institucionit kryhen sipas procedurave të parapara në udhëzuesin për përcjelljen e të burgosurve nr. 495, datë: 06.06.2024.
5. Dhoma e kontrollit për të gjitha lëvizjet e të burgosurve të klasifikuar me rrezikshmëri jashtë dhe kthim brenda institucionit duhet ta njoftojë Qendrën Operative të SHKK-së.
6. Dhoma e kontrollit në rast të ndonjë përcjellje emergjente apo të pa planifikuar për të burgosurit e klasifikuar me rrezikshmëri duhet ta njoftojë sa më parë që është e mundur Drejtorin e Institucionit dhe Qendrën Operative të SHKK-së.
7. Të gjitha lëvizjet e jashtme duhet të bëhen nga Njësia për Përcjelljen e të Burgosurve dhe sipas nevojës edhe me mbështetjen e Policisë së Kosovës. Përgjatimisht, në rastet emergjente kur është e pa mundur që përcjellja të bëhet nga NjPB përcjellja do të bëhet nga stafi i brendshëm i institucionit duke e njoftuar dhe koordinuar me Policinë e Kosovës dhe Qendrën Operative të SHKK-së. Në këto situata, stafi i brendshëm duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për të rritur në maksimum sigurinë e përcjelljes.
8. Pas përfundimit të aktiviteteve dhoma e të burgosurve mund të hapet vetëm me leje të Mbikëqyrësit të Lartë kujdestar, përgjatimisht kur vlerësohet se është në rrezik jeta e të burgosurve dhoma mund të hapet nga zyrtarët korrektues në detyrë.
9. Fotografia me të dhënat e të burgosurve të klasifikuar me rrezikshmëri dhe rutina duhet të jenë të vendosura në divizionin e sigurimit, dhomën e kontrollit, njësinë e vizitave, portën kryesore dhe Qendrën Operative të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Neni 10

Menaxhimi i të burgosurve me rrezikshmëri në institucionet shëndetësore

1. Zyrtarët korrektues të caktuar në detyrë për përcjelljen dhe ruajtjen e të burgosurve të klasifikuar me rrezikshmëri gjatë qëndrimit në institucione shëndetësore duhet të:
 - 1.1. informojnë stafin mjekësor lidhur me nivelin e rrezikut të burgosurit dhe kërkojnë që të sigurohet një zonë sa më e sigurt për vendosjen e të burgosurit.
 - 1.2. informohet Qendra Operative e Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe Drejtori i Institucionit Korrektues përkatës për vendosjen e të burgosurit në spital duke specifikuar klinikën, repartin dhe dhomën ku është vendosur.
 - 1.3. të mbahet komunikim i vazhdueshëm me Qendrën Operative të Shërbimit Korrektues të Kosovës për lëvizjet dhe ndryshimet eventuale gjatë ruajtjes së të burgosurit.
 - 1.4. të evidentohet dhe përditësohet libri i kategorisë për të gjitha ngjarjet që ndodhin në spital në lidhje me të burgosurin.
 - 1.5. zyrtarët e caktuar në detyrë për ruajtjen e të burgosurve me rrezikshmëri të lartë dhe shumë të lartë duhet të jenë të armatosur.

1.6. në çdo rast kur të burgosurit me rrezikshmëri të lartë dhe shumë të lartë hospitalizohen duhet të njoftohet Policia e Kosovës përmes Qendrës Operative të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

1.7. ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për të garantuar sigurinë e situatës dhe për të ruajtur vigjilencën e shtuar dhe për të zbatuar në mënyrë rigoroze procedurën për mbikëqyrjen dhe ruajtjen e të burgosurve gjatë hospitalizimit.

Neni 11

Aktivitetet e të burgosurve me rrezikshmëri

1. Të burgosurve të klasifikuar me rrezikshmëri të jashtme të lartë dhe të jashtme shumë të lartë mund të marrin pjesë në aktivitete të ndryshme rekreative me të burgosur tjerë sipas rutinës të aprovuar nga Drejtori i IK-së.

2. Të burgosurit e klasifikuar me rrezikshmëri të lartë dhe shumë të lartë brenda institucionit aktivitetet i realizojnë sipas rutinës së veçantë.

3. Nëse vlerësohet se të burgosurit e klasifikuar me rrezikshmëri të lartë dhe shumë të lartë nuk paraqesin rrezik mund të marrin pjesë në aktivitete së bashku me të burgosurit tjerë të pa klasifikuar me rrezikshmëri në mbikëqyrje të drejtpërdrejt të stafit në detyrë.

4. Të burgosurit e klasifikuar me rrezikshmëri të lartë dhe shumë të lartë mund të punësohen vetëm brenda krahut dhe perimetrit të pavijonit ku ata janë të vendosur.

5. Të burgosurit e klasifikuar me rrezikshmëri të lartë dhe shumë të lartë mund të marrin pjesë në programet rehabilituese, risocializuese, aftësimi profesional dhe arsimimit me masa të shtuara të sigurisë.

Neni 12

Realizimi i vizitave dhe telefonatave

1. Të burgosurit e klasifikuar me rrezikshmëri të lartë dhe shumë të lartë mund të realizojnë vizitat sipas tretmanit përkatës.

2. Vizitat do të mbikëqyren nga Zyrtaret Korrektues gjatë gjithë kohës së realizimit të vizitës.

3. Të burgosurit e klasifikuar me rrezikshmëri të lartë dhe shumë të lartë si rregull vizitat duhet ti realizojnë ndaras nga të burgosurit tjerë, përjashtimisht në rast të mungesës së hapësirave vizitat mund të realizohen së bashku me të burgosurit tjerë duke shtuar masat e sigurisë.

4. Vizitat me avokatët mbrojtës mund të jenë në monitorim përmes vëzhgimit por jo dëgjimit gjatë kohës së realizimit të vizitës.

5. Të burgosurit e klasifikuar me rrezikshmëri të lartë dhe shumë të lartë duhet të parashetrojnë kërkesë se paku 48 orë para realizimit të vizitës.

6. Lista e vizitorëve për të burgosurit e sapo pranuar të klasifikuar me rrezikshmëri të lartë dhe shumë të lartë duhet të verifikohet nga organet përkatëse për të kaluarën e tyre penale dhe pas pranimit të verifikimit mund të aprovohet nga Drejtori i Institucionit.

7. Telefonatat e të burgosurve të klasifikuar me rrezikshmëri të lartë dhe shumë të lartë do të zhvillohen bazuar në tretmanin përkatës, duke përfshirë edhe komunikimin përmes platformave elektronike.
8. Telefonatat dhe komunikimi përmes platformave elektronike për të paraburgosur duhet të merret aprovimi nga gjykata kompetente.
9. Të gjitha telefonatat do të evidentohen në regjistrin përkatës nga ana zyrtarëve korrektues.

Neni 13

Beneficionet e të burgosurve të klasifikuar me rrezikshmëri

1. Të burgosurit e klasifikuar me rrezikshmëri të lartë dhe shumë të lartë do të gëzojnë të gjitha beneficionet që nuk bien ndesh me pikat e lartcekura, varësisht nga tretmani të cilit i takojnë por pa mundësinë e realizimit të beneficioneve jashtë institucionit.
2. Të burgosurit e klasifikuar me rrezikshmëri të lartë dhe shumë të lartë nuk mund të kalojnë në tretmane tjera të avancuara.
3. Të burgosurit e klasifikuar me kategori të rrezikut të lartë nga jashtë ose shumë të lartë nga jashtë mund të kalojnë në trajtim të avancuar brenda institucionit korrektues, por pa mundësinë e ushtrimit të beneficioneve jashtë institucionit.

Neni 14

Dispozitat Kalimtare

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulle shfuqizohet rregullorja e brendshme e punës Menaxhimi i të Burgosurve me Kategori nëpër IK nr.1171, datë: 15.10.2021.

Neni 15

Formularët e përdorur në këtë udhëzues

1. Shtojcë - Forma Vlerësimit të Rrezikut.

Neni 16

Hyrja në fuqi

Kjo rregullë hyn nga data 10 Prill 2025.

28.03.2025

Ismail Dibrani
Drejtore i Përgjithshëm
Shërbimi Korrektues i Kosovës



Shtojcë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Shërbimi Korrektues i Kosovës / Korektivna Služba Kosova / Kosovo Correctional Service
Institucioni Korrektues:

Forma.3.1.18

Forma e Vlerësimit të Rrezikut

Emri dhe mbiemri i të Burgosurit:		Numri i të burgosurit		Institucioni Korrektues		Pavijoni:	
Data e Lindjes:		Vepra:		I dënuar ☐ I paraburgosur ☐			
Data e arrestit:	Data e pranimit:	Data e lirimit:		I dënuar për herë të parë apo recidivist:			
Tretmani	Pranimit ☐	Themelor ☐		Standard ☐	Avancuar ☐		
Statusi i tanishëm në Burg/Institucion:	Rrezikshmëri Shumë e lartë ☐	Rrezikshmëri shumë e Lartë e Jashtëm ☐		Rrezikshmëri Shumë e Lartë e Brendshëm ☐	Rrezikshmëri e Mesme ☐		
	Rrezikshmëri e Lartë ☐	Rrezikshmëri e Lartë e Jashtme ☐		Rrezikshmëri e Lartë e Brendshëm ☐	Rrezikshmëri e Ulët ☐		
Dënimi i tanishëm:		viti/ muaji/ dita					
Recidivist:							
I dënuar për herë të parë:							
Informata shtesë:							
INFORMATA				PERIUDHA E TANISHME E DËNIMIT			
TË DHËNA TË REGJISTRUARA				PO	JO		
1	Raportet Disiplinore			☐	☐		
2	Dënimet e Shqiptuara Disiplinore			☐	☐		
3	Ndonjë sjellje e pa parashikuar (tentim vetëvrasje, vetëlëndim, etj)			☐	☐		
4	A ka ndonjë procedurë tjetër gjyqësore apo penale			☐	☐		
5	Probleme më të Burgosurit e tjerë / Grupe të Burgosurve			☐	☐		
6	Probleme me Familje të Viktimës / a është pajtuar me familje të Viktimës			☐	☐		
7	Personat e përfshirë në vepër			☐	☐		

Vlerësuar nga Udhëheqësi i Divizionit për Siguri në Institucionin Korrektues:

Emri/Mbiemri: _____

Nënshkrimi: _____

Data: ____ / ____ / ____

Pranuar nga Zyrtari Përgjegjës i Njësisë për Përcjelljen e të Burgosurve:

Emri/Mbiemri: _____

Nënshkrimi: _____

Data: ____ / ____ / ____